



Vechro Pro Bondfix Quartz

Astar hibrid kuarci ngjitës



Rendimenti i mbulimit: 4 - 12

m²/lt



Koha e tharjes: ½ - 1 orë



Hollimi: 0 %



Mundësia për shtresë të dytë

3 - 4 orë



Paketimi: 750 ml, 2,5 lt, 10 lt

Aplikimi: Furçë, rul, pistoletë me spërkatje

KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME

Me pak aromë, përmbajtje e ulët POA, astar hibrid i tretshëm në ujë. Për përdorim tranzit, "material ndërlidhës" mbi sipërfaqet e çimentos, suvasë, bordin e çimentos, pllaka gipsi, polisterenin e zgjeruar ose të shtrydhur, betonin e gazuar, blloqe betoni, mozaikë, tulla, kompensata për përdorim në marinë, dërrasa fibroze me densitet të mesëm, dhe sipërfaqe të tjera druri ose metali, ngjitje tullash, llaç çimentoje, me shpërndarje me shpatull për stuko dhe materiale të tjera të ngjashme. Përdorim i brendshëm & për ambiente të jashtme. Zëvendëson suvanë e trashë. Është rezistent ndaj alkalineve dhe lagështisë. Ngjitje e shkëlqyer. Pas aplikimit krijon një sipërfaqe të ashpër. Gati për përdorim.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Pamja	Mat
Graviteti specifik	1,21 -1,25 g/l
Rendimenti i mbulimit	4-12 m ² /lt për shtresë, në varësi të aftësisë përthithëse të sipërfaqes dhe trashësisë së dëshiruar të shtresës.
Hollimi	Gati për përdorim
Koha e tharjes	E thatë për tu prekur ½ - 1 orë.
Mundësia për shtresë të dytë	Mund të rilyhet për 3-4 orë. Këto afate kohore janë më të gjata në kushte të ftohta dhe me lagështirë.
Klasa e POA	"Astarë lidhës". Lloji Y. Vlera e pragut të POA = 30 gr/lt. Përmbajtja maksimale e POA për produktet e gatshme = 25 gr/lt.
Ngjyra	Okër. Nuk ngjyrosët!



PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Pastroni plotësisht sipërfaqet e vajrave, pjesëve të lira, pluhurit dhe mykut.

APLIKIMI

Përzieni mirë para përdorimit pasi të keni holluar bojën me ujë. Vendosni 1-2 shtresa Vechro Pro Bondfix Quartz në sipërfaqe, në mënyrë që të arrini sipërfaqen e ashpër të dëshiruar.

PASTRIMI I MJETEVE

Gjatë punës, mbajini mjetet "të njoma" në enë ose në tabakanë me bojë. Kullojeni bojën mirë nga mjetet kur ta hidhni përsëri në kuti dhe pastrojini menjëherë ato me ujë të ngrohtë me sapun.

KUSHTET E APLIKIMIT

Temperatura 8-30 °C dhe niveli relativ i lagështirës më i ulët se 80 %. Kushtet e këqija gjatë dhe pas aplikimit mund të ndryshojnë vetitë e produktit në fund. Sipërfaqet e reja duhet të thahen për 3-4 javë para se t'u vendoset astari.

RUAJTJA

Pas aplikimit, mbyllni enën fort për ta ruajtur në gjendje të mirë për përdorim në të ardhmen. Mbajeni në vend të freskët. Mbroni materialet nga ngrirja dhe ekspozimi në diell.

SHËNIME

Produkti nuk kërkon ndonjë etiketë rreziku në përputhje me legjislacionin në fuqi. Më shumë informacion për etiketat e substancave të rrezikshme të produktit në përputhje me legjislacionin Evropian dhe atë kombëtar mund të gjeni në Fletën e të Dhënave të Sigurisë (SDS) të produktit.

UDHËZIME PËR PËRDORIMIN E SIGURT

Lexoni etiketën përpara përdorimit. Mbajeni larg fëmijëve.



Të dhënat dhe udhëzimet teknike në këtë broshurë teknike bazohen në testet laboratorike dhe janë rezultat i njohurive dhe përvojës së stafit shkencor të shoqërisë. Cilësia e produktit garantohet nga shoqëria, i cili është në përputhje me kërkesat e ISO 9001,14001 dhe me rregulloren e EMAS. Si prodhues, ne nuk mbajmë asnjë përgjegjësi për asnjë dëm apo dëme të shkaktuara nëse produkti nuk është aplikuar për përdorimin e duhur dhe në përputhje me udhëzimet për përdorimin.